

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht.

Nga shteti i Italisë sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Ndarja administrative e nivelit 1</i>	<i>Ndarja administrative e nivelit 2</i>	<i>*ndarja administrative e nivelit 3</i>
Sardegna	Cagliari	Cagliari*
Veneto	Padua	Casale Di Scodosia*
Veneto	Verona	Bonavigo*
Emilia-Romagna	Bologna	Crevalcore*
Emilia-Romagna	Ferrara	Codigoro*
Emilia-Romagna	Ferrara	Lagosanto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Giorgio Di Nogaro*
Lombardia	Mantua	Canneto sull' Oglio*
Veneto	Treviso	Valdobbiadene*
Veneto	Treviso	Breda Di Piave*
Veneto	Venezia	Mirano*
Veneto	Venezia	Pianiga*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Villa Vicentina*
Veneto	Treviso	Ormelle*
Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
Emilia-Romagna	Parma	Fontanellato*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 1028, datë 26.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj